Nëntor 2024, nr. 17

# Gazeta e Rahovecit

## Ka përfunduar rinovimi i hapësirave të brendshme të QMF-së në Krushë të Madhe

Komuna e Rahovecit rinovoi hapësirat e brendshme të QMF-së në Krushë të Madhe. Tani QMF-ja i plotëson të gjitha kushtet infrastrukturore sipas standardeve, duke u ifruar edhe profesionistëve shëndetësorë shërbime sa më cilësore.



## Përurohet fusha sportive bashkëkohore në Hoçë të Vogël

Në hapësirën e ShFMU "Heronjtë e Kosovës”, Komuna e Rahovecit përuroi mjediset e reja sportive për futboll, basketboll dhe volejboll, me shtresë gome (TARTAN), që do t’u shërbejnë të rinjve, nxënësve dhe të gjithë qytetarëve të fshatrave Hoçë e Vogël dhe Brestoc, për sport e rekreacion.

